



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion

Mbledhja nr. 22

Prishtinë, më 12 shtator 2011, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 302

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

Në mbledhje morën pjesë: Arben Gashi – kryetar, Behar Selimi, Arsim Bajrami, Ardian Gjini, Halit Krasniqi, Albulena Haxhiu, Armend Zemaj, Amir Ahmeti dhe Jasmina Zhivkoviq.

Munguan: Mufera Şinik dhe Haki Demolli.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Artan Canhasi – EULEX, Lejla Selimi – OSBE, Sylë Ahmeti – Kosova Sot, Lumnije Murati – ZPRK, Haxhi Gashi- USAID, Besim Zeqiri- ICO, Natyra Krasniqi – KDI, Driton Nimani – KTV dhe Fixhrije Dragaj – praktikante.

Nga Stafi i Komisionit për Legjislacion: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Arben Gashi, kryetar i Komisionit.

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 20.07. 2011,
3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-001 për përfitimin e ish- zyrtarëve të lartë,
4. Shqyrtimi i Projektligjit për nisma legjislative,
5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-35 për Riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasuritë e tyre,
6. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-49 për zjarrfikje dhe shpëtim,
7. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 20.07. 2011

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 20. 07. 2011, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-001 për përfitimin e ish- zyrtarëve të lartë

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion lidhur me këtë pikë njëzëri nxori këtë

Përfundim

1. Formohet grupi i punës për shqyrtimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-001 për Përfitimin e ish- zyrtarëve të lartë, në këtë përbërje:

Albulena Haxhiu, kryesuese, Halit Krasniqi dhe Amir Ahmeti - anëtar.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për nisma legislative

Kryetari kërkoi nga Arsim Bajrami, si kryesues i grupit të punës, të paraqesë arsyetimin për amendamentet e propozuara për këtë projektligj.

Arsim Bajrami, në cilësi të kryesuesit të grupit punues, e njoftoi Komisionin se grupi punues ka paraqitur 6 amendamente në P/L për nisma legislative. Ai dha sqarime për secilin amendament duke shtuar se këto ndryshime e bëjnë projektligjin më të plotë dhe të zbatueshëm dhe kërkoi që këto amendamente të përkrahen.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë:

Përfundim

I. Miratohet Raporti me amendamente i Komisionit për Legjislacion.

II. I rekomandohet Kuvendit të Kosovës miratimi i Projektligjit për nisma legislative me amendamentet e propozuara.

III. Amendamentet e miratuara janë paraqitur si aneks i këtij procesverbali.

5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 04/L-35 për Riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasuritë e tyre

Komisioni e shqyrtoi raportin me amendamente në Projektligjin për Riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasuritë e tyre. Anëtarët e Komisionit paraqiten vërejtje në mënyrën e hartimit të amendamenteve për paqartësinë e tyre.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë

Përfundim

1. Projektligji nr. 04/L-35 për Riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasuritë e tyre, e ka bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e Komisionit Funksional e kanë bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe nuk janë në mospajtim me ligjin e zbatueshëm në Kosovë.
3. Komisioni ripërsërit vërejtjet në formulimin e amendamenteve, sepse nuk e kanë qartësinë e duhur dhe nuk janë të hartuara në pajtim me rregullat e hartimit të legjislacionit.
4. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

6. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin nr. 04/L-49 për zjarrfikje dhe shpëtim

Kryetari e paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit Funksional në Projektligjin për zjarrfikje dhe shpëtim dhe kërkoi nga anëtarët të deklarohen nëse ka vërejtje për amendamentet.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë

Përfundim

1. Projektligji nr. 04/L-49 për zjarrfikje dhe shpëtim, e ka bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e Komisionit Funksional e kanë bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe nuk janë në mospajtim me ligjin e zbatueshëm në Kosovë.
3. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

Mbledhja përfundoi në orën 12:15.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetar i Komisionit

Arben Gashi

Amendamentet në Projektligjin për nisma legislative

Amendamenti 1

Neni 3, paragrafi 1.3, fjala **“Organizatori”** hiqet dhe zëvendësohet me fjalën **“Përfaqësuesi”** dhe ky ndryshim terminologjik vlen për tërë tekstin e Projektligjit.

Amendamenti 2

Neni 4, titulli **“Parimi i përgjithshëm për nismën legislative”** hiqet dhe zëvendësohet me **“Nisma legislative”**.

Amendamenti 3

Neni 17 riformulohet si vijon:

“Verifikimi i listës

1. Lista që përfshinë të paktën 10.000 nënshkrime verifikohet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në afat prej 15 ditëve.
2. Në rast të ndonjë mangësie të gjetur në kuptim të nenit 16 të këtij ligji gjatë procesit të verifikimit të listës Komisioni Qendror i Zgjedhjeve e njofton përfaqësuesin e nismës që në afat kohor jo më shumë se 30 ditë të përmirësojë listën e nënshkrimeve.
3. Në rast se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve konstaton se nisma është në pajtim me kushtet e përcaktuara me këtë ligj, brenda 3 (tri) ditëve e njofton përfaqësuesin e nismës legislative.”

Amendamenti 4

Neni 18 riformulohet si vijon:

“Dërgimi i nismës në Kuvend

1. Projektligji apo propozimi i hartimit të një projektligji të caktuar së bashku me shkresën shpjeguese për objektivat që synojnë t'i realizojnë të nënshkruar nga të paktën 10.000 qytetarë i paraqitet Kuvendit nga përfaqësuesi i nismës.
2. Përfaqësuesi i nismës Projektligjin e dorëzon te Kryetari apo Kryesia e Kuvendit, në mënyrë solemne.”

Amendamenti 5

Neni 19, në fund, pas fjalës **“kompetente”** shtohen fjalët **“për konteste administrative.”**

Amendamenti 6

Shtohet neni 23 me këtë përmbajtje:

“Dispozitat e këtij ligji do të vlejñë në mënyrë analoge edhe për nismat për amendamentimin e ligjeve.” Ndërsa neni 23 bëhet 24.